



POP 5 Lajmet më të lexuara të 5 minutave të fundit

- 1

Shpërthimi me 6 të lënduar në Lezhë, flet i sëmundit i familjes Kola: Sajmiri martonte nesër vajzën e vëllait! Fillimisht kujtova se u ça ndonjë gomë kamioni
- 2

Tirana pa drejtues në zyrë, Kryeministria: Situata, pasojë e burgosjes së Vella! Kushtetuesja foli qartë, është kryetari! Cënohet marrja e shërbimeve
- 3

'Shqipëria na bashkon', aktori Leonit Maloku në 'Minuta Zero': Edhe kur Iuan Kosova me flamurin kuqezi festojmë
- 4

VKM/ Shqipëria ngrë Task-Forcën për Samitin e NATO-s 2027 në Tiranë, SHISH e FAI Ja detyrat për organizimin
- 5

Aeroporti i Vlorës/ MABCO dhe 2A Group takim me Ministrinë e Infrastrukturës, kompania e Pacollit: Na u la kohe të paraqesim propozimet për rifillimin e punës

Kronikë

Parandalohet vrasja në Kavajë/ I dhunuan nipin për pagesë, xhaxhai merr kallashnin dhe niset drejt hotelit për të vrarë autorët! Arrestohet djali i pronarit, tjetri në kërkim (VIDEO)

Një konflikt për pagën e një 18-vjeçari, Genti Nela që punonte si kamerier në lokalin e një hoteli në zonën e Malit të Robit, në Golem, rrezikoi të përfundonte në një ngjarje të rëndë kriminale.

Parandalohet vrasja në Kavajë/ I dhunuan nipin për pagesë, xhaxhai n

Report TV



Watch on

Redaksia 29 Gusht, 11:30 | Përditësimi: 29 Gusht, 15:01

Share Post WhatsApp



KAVAJË. Parandalohet një ngjarje në zonën e Golemit e cila mund të përfundonte në një tragjedi. Një 18-vjeçar Genti Nela që punonte si kamerier në lokalin e hotelit 'Flar' në zonën e Malit të Robit, është dhunuar pasi kërkoi pagën e tij.

I riu u dhunua nga dy djemtë dhe dhëndri i pronarit të hotelit, si edhe një shok i tij 20-vjeçar. Xhaxhai i tij, pasi mësoi çfarë kishte ndodhur, u nis i armatosur drejt hotelit për t'u hakmarrë dhe për të vrarë autorët e dhunës.

Policia ndërhyri para se 47-vjeçari të mbërrinte në hotel dhe ndaloi makinën e tij në afërsi të zonës. Brenda një çante shpine u gjet një kallashnikov, tre karikatorë dhe 84 fishekë.

Melison Nela, xhaxhai i 18-vjeçarit u arrestua.

LEXO EDHE: Krujë/ Zjarr mes Kroit të Madh dhe fshatit Cudhi, flakët përhapen në sipërfaqe të mëdha! E pamundur ndërhyrja e automjeteve zjarrfikëse (VIDEO)



Për dhunimin e kamerierit u arrestuan Florian Habilaj, 28 vjeç, djali i pronarit të hotelit, dhe Enold Dragoti, 20 vjeç, ndërsa djali tjetër i pronarit, Arbër Habilaj, 36 vjeç, u shpall në kërkim. Dhëndëri 36-vjeçar i pronarit, po hetohet në gjendje të lirë.

Gjatë kontrolleve policia konstatoi se vendi ku kishte ndodhur konflikti ishte pastruar, ndërsa pajisja ku ruheshin pamjet e kamerave të sigurisë ishte hequr dhe kabllo të ishin prerë.

"Shërbimet e Komisaritit të Policisë Kavajë dhe të Stacionit të Policisë Golem, pas marrjes së njoftimit për një konflikt në një hotel në zonën e Malit të Robit, Golem, kanë shkuar menjëherë në vendngjarje, duke parandaluar përshkallëzimin e mëtejshëm të konfliktit. Nga veprimet e para hetimore rezultoi se shtetasi F. H., së bashku me shtetasit A. F., E. D. dhe M. M., kanë dhunuar shtetasin G. N., 18 vjeç, kamerier në lokalin e hotelit, për shkak të mosdhënies së pagesës për punën e kryer. 18-vjeçari ndodhet në Spitalin e Kavajës, nën kujdesin e mjekëve.

Gjatë kryerjes së veprimeve, shërbimet e Policisë kanë marrë informacion në rrugë operative se xhaxhai i 18-vjeçarit, shtetasi M. N., 47 vjeç, banues në Kavajë, i armatosur me armë zjarri, ishte nisur drejt hotelit, me qëllim vrasjen e personave që kishin dhunuar nipin e tij. Shërbimet e Policisë kanë ndërhyrë menjëherë, duke ndaluar në afërsi të hotelit automjetin që drejtohej nga ky shtetas. Gjatë kontrollit të automjetit, në një çantë shpine, shërbimet e Policisë gjetën një armë zjarri automatik, kallashnikov, 3 karikatorë dhe 84 fishekë luftarakë. Po nga veprimet hetimore rezultoi se vendngjarja ishte pastruar, DVR-ja e kamerave të sigurisë ishte hequr dhe kabllo të ishin prerë. Në përfundim të veprimeve të para hetimore, u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve F. H., 28 vjeç, dhe E. D., 20 vjeç, banues në Kavajë; u shpall në kërkim shtetasi A. F., 36 vjeç; u procedua në gjendje të lirë shtetasi M. M., 36 vjeç, banues në Kavajë. Gjithashtu u bë arrestimi në flagrancë dhe i shtetasit M. N., 47 vjeç, banues në Kavajë", njofton Policia.

Në bashkëpunim me Prokurorinë, vijon puna për dokumentimin e plotë ligjor të kësaj ngjarjeje. Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë për veprime të mëtejshme.



Hoteli ku ka ndodhur ngjarja

Sqarim: Çdo person prezumohet i pafajshëm deri sa nuk vërtetohet fajësia e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë

Sl.E./Shqiptarja.com

TAG: Arber Habilaj Enold Dragoti Florian Habilaj Melison Nela Durrës flar

Sa e vlerësoni këtë artikull? ★★★★★

LAJMET MË TË VLERËSUARA

Komente

Komento

- Beni:

29/08/2026 14:04

Ja pra, biznesmenat shqiptar te turizmit. Kafsh te egra me lek krimi. Pastaj ankohen qe nuk gjejne punetor.
- Dulla:

29/08/2026 12:21

Bravo daja hallall ta boft zoti askush ska drejte me prek njeri me dore,paskan pas mbeshtetje nga policia ata pranaj rrafin rob kot,kur i ka dal ustai kan shku duke u fut si skuthat naper brima e tu lajmeru policine se kur e ka rraf çunin e dajes se kan njoftu,pleraa

Ndalohet repretësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës: Si ju duket plani i qeverisjes i paraqitur në Pogradec nga Rama?

Mirë Keq Nuk e di

Lajme të tjera

- Protestë në Spitalë kundër Bashkisë në Durrësit! Banorët: Punimet për kolektorin janë ndërprerë prej disa muajsh! Rrezikojmë të përmbytemi

Artur Korriku

29 Gusht, 11:45
- BE e futi në 'listën e zezë', anijes së 'flotës hije' ruse i ndalohet ankorimi në Portin e Durrësit! Në 2025-ën theu embargon, transportoi 30 mijë tonë naftë ruse drejt Turqisë

29 Gusht, 08:51
- Tatimet kontrolle në 12 biznese në Durrës, konstatohen mbi 40 shkelje të legjislacionit! 540 mijë euro të ardhura të padëklaruara vetëm në një prej pajisjeve të sekuestruara (VIDEO)

28 Gusht, 21:31
- I akuzuar për kanosje në Norvegji dhe trafik droge në Shqipëri, arrestohet 28-vjeçari në Durrës (EMRI+VIDEO)

28 Gusht, 11:44
- Gjendet bombë artizanale në Durrës, dyshohet se ra nga një makinë në lëvizje! Merret për ekspertizë nga forcat xheniere (VIDEO)

28 Gusht, 09:57
- 'Audi' përplas për vdekje 13-vjeçarin me monopatinë në Lezhë, shoqërohet drejtuesi! Mjeti përherë në kanal në Fushë-Krujë, vdes shoferi (VIDEO)

27 Gusht, 20:47
- Aksident me vdekje në aksin Fushë Krujë-Borizan, makina del nga rruga dhe Humb jetën drejtuesi (EMRI)

27 Gusht, 17:51
- Mbante pa leje pistoletë me municion, arrestohet 61-vjeçari në Krujë (EMRI+VIDEO)

27 Gusht, 11:36
- Qytetet më të 'shkreta', Korita për mbi 80% të territorit pa banorë! Durrësi vetëm 20,6%

27 Gusht, 07:53
- Arrestimi i Ergys Agasit, opozita 'breshëri' reaguesh! Berisha: U kap apo 'dorëzim me kushte'? Procesi gjyqësor ndaj tij të monitorohet nga ndërkombëtarët

26 Gusht, 22:25
- U prangos sot në Durrës, akuzat që rëndojnë mbi Ergys Agasin! Mbi 9 milionë eurot që mori si rryshfet për tenderët e paracaktuar në AKSHI (DOSJA)

26 Gusht, 21:50
- Policia konfirmon arrestimin e Ergys Agasit në Durrës! Në pranga edhe Uljan Shpataraku! Ish-polici i shpallur kërkim pasi kërcënoi me jetë stafin e hotelit në Dhërmë

26 Gusht, 20:49

Lajmi i fundit



Kosovë/ Kurti takohet sërish me Abdiçhikun, nuk ka dakordësi për Presidentin! Kreu i LVV: Kur të kemi rezultate, do të ketë edhe lajme!

29 Gusht, 23:01

